

Nr/Br 01-527
Me/Dona: 26.09.2019



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e nëntë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 24.09.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Drejtori i Administratës Driton Abdyli, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendetë të pranishmit tha: para se të fillojm me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Buxhetit për vitin 2020-2022;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Drejtori i Financave Sercan Todorovic pasi pershendetë të pranishmit tha: pasi që Kryetari është propozues i pikës së dytë për aprovimin e buxhetit dhe Kryetari nuk është këtu për arsy se është në bisedime me Kryeministrin për disa projekte kapitale kerkoi që kjo pikë të terhiqet nga rendi i ditës dhe kerkoi që të mbahet një mbledhje e jashtzakonshme për aprovimin e buxhetit.

Kryesuesi tha: Drejtor ju keni thënë se është von që të aprovohet buxheti me 30 shtator, por nese ju kerkoni ta terhiqni atëher unë e hudhi ne votim, kush është për terhjekjen e pikës së dytë?

Për terhjekjen e pikës së dytë votuan 6 antarë për 9 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Dragana Dimic, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Dobrivoje Djordjevic, Ivica Cenic).

Sercan Todorovic tha: pasi që Kryetari nuk është këtu kerkoi që të shtyhet kjo pikë dhe unë e leshoj mbledhjen e ju aprovone buxhetin.

Ramush Mehmeti pasi pershendetë të pranishmit tha: unë mendoh se Drejtori realisht ka të drejt të kerkoi terheqjen e pikës, ne nuk mundë ta aprovojm buxhetin nese egzekutivi kerkon që të terhiqet pikë nga rendi i ditës, andaj kerkoi mirëkuptim për terheqjen e pikës dhe e mbajm një seanc të jashtzakonshme.

Abdyl Gashi pasi pershendetë të pranishmit tha: ne me material na ka ardhur aprovimi i buxhetit dhe është dasht të mendohet më heret që mos të na dergojn material dhe të vim ne mbledhje te maltretohem me një pikë të vetme në rend dite. I kemi propozimet prej qytetarëve gjithashtu edhe

Procesverbali i Kuvendit

prioritetet tona se ku është më mirë të investohet dhe të përkrahen ato fshatra. Kryetari është duhur të jetë këtu por vazhdon të mos mer pjesë në mbledhje, mendoj se vetem kur po i duhet atij për me terhjek pika po kerkon një status kohë për me ndryshu, mendoj se nuk është shkelje ligjore nese sot e aprovojm buxhetin ashtu siç është në të miren e qytetarëve.

Drejtori i Financave tha: Kryetari është propozues i buxhetit dhe Kuvendi vetem e aprovon, Kryetari nuk është këtu për arsyen se gjendet në Ministri për disa projekte kapitale.

Kryesuesi tha: 30 shtator është vonë që të mbajm mbledhje për aprovimin e buxhetit.

Drejtori tha: mund ta mbajm të premten pasdite.

Ramush Mehmeti tha: mendoj se nuk prish punë asgjë që të mbajm seanc të premten, ato që kemi vendosur ti kalojm do ti kalojm, bazë ligjor ka që të tèrhyk piken nga rendi i ditës.

Selatin Nuhiu pasi pershendetë të pranishmit tha: puna e buxhetit nuk është punë hajgare pasi që është në pyetje buxheti për një vit, sot Kryetari është duhur të jetë ne mbledhje ose ne para mbledhjes është dasht të bisedojm me ju Kryesues, pasi që ka edhe shumë qytetar të pranishem që presin që të aprovohen projektet e tyre që i kanë paraqit, kjo tregon se egzekutivi nuk është serioz në raport më Kuvendin.

Kryesuesi tha: pasi që propozuesi i rendit të dites kerkon terheqjen e pikës nga rendi i ditës, propozoj që ta terheqim piken për aprovimin e buxhetit për vitin 2020-2022 dhe do të mbajm një mbledhje të jashtzakonshme të premten.

Dobrivoje Djordjevic tha: ne jemi pyetur dhe kemi votuar kunder shtyerjes së pikes së dytë, ju në fillim është dashur të na njoftoni se pajtoheni me terheqje të kesaj pike e jo pasi që votum.

Kryesuesi kaloj në piken e parë.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutim aprovohet procesverbalı nga antarët prezent të Kuvendit me 11 vota për, 2 apstenime dhe 2 nuk kan votuar.

Kryesusi tha: pasi që pika e dytë u terhjek kalojm në piken e tretë.

Pika e tretë: Të ndryshme.

Abdyl Gashi tha: po e ngris një shqetësim timin dhe të qytetarëve që ka të bëjë me web faqen zyrtare dhe rrjetin social qysh është facebooki, aty bëhen shperndarje vetem në gjuhen serbe dhe në Komunën tonë jetojnë më shumë se dy komunitete dhe është e padrejt që vetem një gjuhë të perdoret, mendoj se i perket edhe Nënkyetarit Shqiptarë që të mirret më këtë qështje pasi që është për ti mbroj të drejtat e komunitetit Shqiptarë në Komunën tonë.

Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri pasi pershendetë të pranishmit tha: është e vertet ajo që e tha antari i kuvendit, vertet është shqetësuese dhe unë e kam paraqit këtë rast. Në faqen e facebook-ut unë nuk e di se kush e menaxhon por është në emer të Komunës por të gjitha postimet bëhen në gjuhen serbe dhe në alfabetin cirilik, natyrisht që është e drejt e tyre kushtetuese edhe alfabeti cirilik por ta pketen edhe nese nuk është në gjuhen shqipe të jetë ne alfabetin latinik të pakten që dikush që e njeh gjuhen me kuptu por as atë mundësi nuk e ka, prandaj dy gjuhësia duhet të respektohet dhe të gjithë ata që e mirëmbajn këtë web faqe duhet pasur parasysh që të jenë në të dy gjuhët, ashtu si the natyrisht që edhe mu më takon me u mirrë me këtë qështje por i takon edhe zv.Kryesusit për komunitete qështjet të cilat kanë të bëjnë me shkelje mundë ti ngrit dhe mi drejtu edhe në gjykat kushtetuese, edhe unë po i bashkangjitem kerkeses tuaj dhe po them prej këtij mikorofoni se ata të cilet e mirëmbajn faqen ne facebook të Komunës së Novobërdës ta kenë në të dy gjuhët, ju faleminderit.

Kryesusi tha: sa i perket mbledhjes së jashtzakonshme propozoj që të mbahet të premten prej ores 10.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic

Kryesues i Kuvendit